



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - RepublicofKosovo**

**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 04.05.2022,
duke filluar në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Arbnora Berisha, Mirsad Vitia, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri dhe Bahri Gashi.

Mungoi: Shegë Beqiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Adelinë Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Florim Krasniqi, udhëheqës i Sektorit të Planifikimit dhe Osman Bllaca.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Fehmi Kupina, kryesues**. Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Valbona Makolli - Ahmeti** propozoi në emër të kryetarit, të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës: "Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë.

Mimoza Sylejmani propozoi në emër të kryetarit, të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës: "Propozimvendimi për lënien në diskutim për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01 nr. 35 - 94056, dt. 04.05.2015, të Planit rregullues "Arberia 3";

Gëzim Sveçla për këto dy pika që po shtohen kërkoi me iu dërguar materialet.

Valbona Makolli - Ahmeti tha se për subvencionimin sot iu vjen materiali.

Kryesuesi e hodhi në votim komplet rendin e ditës, me pikat shtesë.

R E N D I I D I T Ë S:

1. Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për shfuqizimin e pjesërishtëm të Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-0088887/20, dt. 11.06.2020;

3. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomeve në Prishtinë;
4. Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë;
5. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktivitetave "3x3 Prishtina Fiba Challenger";
6. Propozimvendimi për subvencionimin e nënave lehona, përfituese të skemës sociale (për të posalindurit e tyre);
7. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;
8. Shqyrtimi i përgjigjes nga MAPL, lidhur me Vendimin për caktimin e lokacionit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve;
9. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë;
10. Propozimvendimi për lënien në diskutim për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01 nr. 35-94056, dt. 04.05.2015, të Planit rregullues "Arbëria 3";
11. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky rend dite.

Pika e parë

Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;

Gëzim Sveçla tha se për këtë pikë të rendit të ditës e kemi pasur një takim shefat e GP-ve, kemi diskutuar, ku shefi i grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i ka shprehur disa pakënaqësi. Këtë pikë të rendit të ditës ne si shefa të GP -ve duhet me trajtuar pas mbajtjes së KPF -së.

Kryesuesi tha se ka pasur një ankesë shefi i GP -së së AAK-së, prandaj e kemi sjellë prapë këtu. Bahri Gashi kërroi nga kryesuesi të cekë se pse ka qenë ankesa. Ankesa ka qenë se nuk më keni ftuar, më keni anashkaluar.

Leutrim Retkoceri theksoi se në trajtimin e kësaj pike të rendit të ditës është mirë me qenë pjesë edhe dikush nga AKR, mos me bërë gabimin e njëjtë dy herë. Propozoj që kjo pikë të shtyhet për një ditë tjeter, kur të jenë kompletuar përfaqësuesit e të gjitha GP -ve edhe ata të AKR-së.

Bahri Gashi u shpreh i pajtimit me qëndrimin e Leutrimin, dhe kërroi me pasur formulën që po përmendet.

Kryesuesi tha se të gjithë do ta keni, vetëm përqindja është.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dytë

Propozimvendimi për shfuqizimin e pjesërishëm të Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-0088887/20, dt. 11.06.2020.

Valbona Ahmeti - Makolli dha sqarime lidhur me shfuqizimin e kësaj pike, duke cekur se prej Kuvendit komunal ka ardhur kërkesë për subvencionimin të bizneseve të vogla në emër të pandemisë, me shumë prej 50 milion e 51 mijë euro ku kanë qenë 4.952 biznese. Kërkesa e shfuqizimit është se disa biznese, 203 nuk i kanë pasur dokumentet e duhura ose kanë qenë bashkëpronarë me dikë dhe nuk kemi mundur me ia qitur në llogari mjetet se ka qenë vetëm një llogari e përbashkët. Po ashtu, 20 biznese janë paguar një herë, por për shkak të gabimeve të ndryshme janë kthyer mjetet prapë. Po ashtu, 20 OJQ-ve nuk e di si ATK-ja i ka lejuar, se OJQ - të nuk kanë qenë të përfshira në këtë pako. Tani pas dy vitesh kemi kërkesa të ndryshme se i kanë rregulluar dokumentet. Ne dhe komisioni është shpërbërë se ka pasur afat ligjor, kështu që po kërkojmë që, këto kërkesa janë të rralla por mos të kemi fare, ta shfuqizojmë këtë vendim, nuk kemi më të bëjmë me ta.

Gëzim Sveçla bëri disa pyetje lidhur me këtë pikë, nga 5 milionë e 2.591 që kanë qenë subvencionim, sa janë shpërndarë prej kësaj shume, sa është shuma që po e anulojmë, mjetet a janë të shpenzuara diku tjetër.

Valbona Ahmeti - Makolli u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

Leutrim Retkoceri u shpreh i pajtimit se duhet shfuqizuar ky vendim.

Kryesuesi konstatoi se u miratuan Propozimvendimi për shfuqizimin e pjesërishëm të Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-0088887/20, dt. 11.06.2020 dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomeve në Prishtinë.

Valbona Ahmeti - Makolli dha sqarime, duke thënë se rrëth një vit e gjysmë e kanë pritur Shoqatën e Gastronomëve dhe ky vendim për subvencionimin ka qenë i aprovuar prej Kuvendit komunal në emër të pandemisë, por kur ka ardhur te pagesa dhe dokumentet që ne nuk i kërkojmë, ne vetëm ia kryejmë një shërbim Ministrisë së Financave, ata i kanë kërkuar dokumentet, ata nuk i kanë pasur dokumentet, i kanë sjellë të Odës Ekonomike. Ne iu kemi thënë nuk guxojmë, se Vendimi është bërë në emër të kësaj shoqate në emër të pandemisë, ne i kemi pritur që do t'i rregullojnë dokumentet, por nuk kanë arritur andaj ky vendim tani anulohet.

Gëzim Sveçla pyeti se kur ka qenë kontakti i fundit me shoqatën, d.m.th. nuk kanë arritur me i përbush obligimet, pyeti se këto mjete a ngelin pastaj në kategori të subvencioneve, apo i dedikojnë diku tjetër.

Valbona Ahmeti - Makolli dha sqarime.

Leutrim Retkoceri tha se kjo ka qenë iniciativë e mirë në atë kohë për me iu ndihmuar, por e keqja është se nuk kanë mund me qenë të përgatitur, Kjo dëshmon edhe një herë se ka rregulla dhe janë duke respektuar ato rregulla dhe në bazë të kësaj në aspektin financiar deri këtu, me këtë Vendim i bie se ka shkuar çdo gjë në rregull.

Bahri Gashi sugjeroi që brenda mundësive me ua caktuar nga një afat këtyre njerëzve.

Valbona Ahmeti Makolli tha se ka qenë pandemi dhe janë thirrur unanimisht nga Kuvendi komunal që me iu ndihmuar.

Milazim Vitija theksoi se ka qenë pjesë e këtij Vendimi që janë ndarë 50.000 € për Shoqatën e Gastronomeve të Prishtinës dhe është arritur një marrëveshje unanime që t'u ndahen mjete, mirëpo me sa e di unë, nuk kanë arritur të themelojnë shoqatën, e kjo ka qenë arsyë që Ministria ua ka kthyer këto mjete, si kanë marrë, andaj pajtohem ta diskutojmë e ta votojmë në seancë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomeve në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë.

Granit Rugova tha se sa i përket subvencionit të këtyre klubeve ka qenë si praktikë e mëhershme, të gjitha këto ekipe janë OJQ që janë të ekipeve më të vjetra në Prishtinë, që ndoshta garojnë dhe përfaqësojnë Prishtinën edhe në arenën vendore dhe ndërkombëtare, andaj e kemi parë të rrugës këtë praktikë me vazhduar edhe kësaj here.

Gëzim Sveçla parashtroi disa pyetje: Si ka qenë kriteri që janë përzgjedhur këto klube?

A keni ndonjë raport financier se si janë shpenzuar këto mjete në të kaluarën? Këto mjete a ju jepen akademive të klubeve apo i jepen në kuptimin e organizimit të brendshëm, apo janë paga që ju jepen këtyre lojtarëve? A jeni të sigurte se të gjitha janë OJQ? A keni mundësi për seancën e Kuvendit me na i dërguar me e-mail të dhënët për statutin e klubeve?

Te klubi i volejbollit, KV "Prishtina" meshkujt, qenkan 11 mijë euro, por te hendbolli për femra nuk paska fare subvencion.

Granit Rugova dha përgjigje në pyetjet e parashtruara.

Gëzim Sveçla pyeti se a kemi të drejtë ne me u bërë aksionarë të klubeve, pse nuk bëhem ne aksionar të klubit, Komuna e Prishtinës me u bërë aksionarë në Klubin e Basketbollit. Ai shprehu besimin se duhet me u rritur vlera e subvencioneve në të ardhmen për klubet tjera, për shkak se dikush 53 mijë euro e dikush ka problem edhe mjetet e udhëtimit me i siguruar edhe me u rritur klubet.

Osman Bllaca dha sqarime për këtë.

Granit Rugova u shpreh i pajtimit me z. Gëzimin për aksionarë të klubeve, ndërsa klubet e vogla subvencionohen përmes subvencioneve të drejtorisë por ne nuk mundemi me i shti në një thes si ekipet amatore dhe këto profesionale.

Gëzim Sveçla tha se nuk pajtohem me qasjen që po thua klubet e vogla, p.sh. se nuk mundesh me i thënë klubit "2 Korriku" klub i vogël, se nga "2 Korriku" janë dalë 2 lojtarë që luajnë në kombëtaren e Shqipërisë, 2-3 që luajnë në kombëtaren e Kosovës.

Granit Rugova dha sqarime.

Gëzim Sveçla shprehu mendimin se duhet të bëhet një strategji për kritere të caktuara se si jepen subvencionet, dhe e përkrah këtë pikë.

Jeta Rafuna tha se e përkrah këtë subvencionim të këtyre klubeve, duke shpresuar që vitin e ardhshëm të rritet, të shtrihen subvencionet edhe për klubet tjera edhe për sportet luftarake, me i pasur parasysh klubet luftarake.

Leutrim Retkoceri e përkrahu Vendiminn për subvencionimin dhe u pajtua me qëndrimin e Gëzimit për aksionet në klube. Kjo është e mirë dhe mendoj se sa i përket shumave për herën tjetër duhet me u rritur, suficite kemi mjaft, mjete kemi.

Granit Rugova bëri të ditur se është rritur një shumë e vogël vetëm sa me thënë është rritur.

Ata që marrin këtu subvencione, nuk kanë të drejtë me marrë në drejtori.

Bahri Gashi u shpreh i pajtimit me parafolësit dhe shprehu mendimin se shuma prej 127 mijë eurove është shumë pak për sport.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktiviteteve "3x3 Prishtina Fiba Challenger".

Granit Rugova tha Fiba "3x3" Prishtina Challenger, është një event shumë i madh dhe është hera e parë që mbahet në Prishtinë, ku pritet të vijnë 16 shtete të botës, njëra prej tyre pritet të jetë edhe Kina. Përkrahja ka qenë shumë e madhe prej Ministrisë së Sportit, e cila i ka ndarë 120 mijë € prej Federatës dhe e kemi pa të arsyeshme pasi mbahet në Prishtinë, të përkrahet edhe nga Komuna. Kërkesa e tyre ka qenë diku 45 mijë €, por ne e kemi pa të arsyeshme me i subvencionuar me 25 mijë €.

Gëzim Sveçla pyeti se kush është organizator?

Granit Rugova tha po, si OJQ.

Bahri Gashi u shpreh se për njerëzit që kanë me ardhur, çfarë është përgatitja e Drejtorisë në akomodimin e tyre, a kemi ne ndonjë obligim si Komunë apo ata e bëjnë krejt vetë.

Granit Rugova tha se ne vetëm i subvencionojmë dhe iu kemi dhënë pëlqimin që të mbahet te Grandi, ndërsa punën organizative e marrin ata vetë, në koordinim me Fiba dhe Federatën e Basketbollit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktiviteteve "3x3 Prishtina Fiba Challenger" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për subvencionimin e nënave lehona, përfituese të skemës sociale (për të posalindurit e tyre).

Adelinë Sahiti dha sqarime, duke thënë se me takimet që i kanë të drejtpërdrejta me qytetarët në kategori të ndryshme sociale, të cilët i përkasin skemës sociale, kemi pasur kërkesa të vazhdueshme për mbështetjen e nënave lehona, të cilat pas lindjes kanë preokupime të ndryshme, ku drejtoria jonë së bashku me Fakultetin e Filozofisë kemi zhvilluar një hulumtim, ku kemi pa se në këto familje që i përkasin skemës sociale mesatarja e të ardhurave të tyre është 103 €, ku as pakon bazike të ekzistencës nuk mund ta sigurojnë.

Komuna e Prishtinës duke parë se është e domosdoshme mbështetja për nënët lehona që janë përfituese të skemës sociale, për herë të parë ka marrë vendim për subvencionimin e tyre me një shumë prej 500 €. Ky subvencionim bëhet vetëm një herë në vit.

Gëzim Sveçla parashtroi disa pyetjen se a ka ndonjë përllogaritje sa është numri i përafërt i lehonave nga skema sociale.

Adelinë Sahiti u përgjigj, duke thënë se janë 70 lehona përafërsisht brenda vittit që janë përfituese të skemës sociale, por ta kemi parasysh se është në rënien numri i lindjeve në komunën tonë por edhe në Kosovë.

Gëzim Sveçla pyeti se a keni menduar mbasi kenë buxhet të mjaftueshme me i rritur kategoritë e subvencionimit në këtë drejtim, për shkak të rënies së natalitetit, p.sh. subvencionimin e fëmijës së tretë etj.

Valbona Ahmeti - Makolli u përgjigj, duke thënë se në tri vitet e fundit ka qenë shuma 300-350 mijë €, duke e pasur parasysh se nga pandemia është rritur numri i kérkesave të të gjitha rasteve, ka shkuar në 800 mijë € shuma për vitin 2022.

Jeta Rafuna e mbështeti përkrahjen e këtij propozimvendim për subvencionim.

Ajo tha se në mandatin e kaluar ne kemi bërë propozim për t'i subvencionuar të gjitha nënët që lindin, mirëpo përgjigja e drejtoreshës ishte që duhet bërë një hulumtim, për të shikuar se numri i lindjeve në Prishtinë është shumë më i madh se në komunat tjera.

Valbona Ahmeti - Makolli dha sqarime për këtë.

Leutrim Retkoceri tha se propozimi është mirë kështu me filluar, pastaj vitin e ardhshëm veç duhet me u rritur edhe shuma, por duhet me u rregulluar disa mekanizma, që pajtohem me drejtoreshën, është tavani i Ministrisë që ta lejon për subvencionim, por ne si Komunë duhet të bëjmë njëfarë kushtëzimi. P.sh., njerëzit që banojnë 10 vjetët e fundit, nuk është e mundshme ata mos me qenë banorë të Prishtinës. Ne duhet ta rregullojmë këtë çështje, se ata nuk na llogarisin neve si banorë të Prishtinës për me mundur me marrë subvencione më shumë dhe buxhet më shumë.

Bahri Gashi u interesua për kohëzgjatjen e këtij vendimi dhe për mundësinë e ndryshimit të vlerës, sepse është pak, andaj shikojeni mundësinë e rritjes së vlerës.

Adelinë Sahiti u përgjigj, duke thënë se për një vit e kanë në formë retroaktive, prej 1 janari që hynë në fuqi deri në fund të vitit, ndërsa sa i përket vlerës, nuk mund të rritet më shumë se 500 €.

Gëzim Sveçla u interesua se në aspektin ligjor dhe financiar a është e mundur që ky subvencion me u rritur qoftë për njëherë, qoftë 2 muaj nga 500 € dhe te pjesa teknike qysh kalojnë, a i kalojnë bartësit, përfituesit të skemës sociale apo nënave direkt.

Milazim Vitija u shpreh në përkrahje të kësaj iniciative. Ai tha se shumica e lindjeve bëhen në spitalin e Prishtinës, pavarësisht prej cilës komunë janë, dhe ata fëmijë regjistrohen në spital, andaj kisha propozuar që të gjendet një formë që të gjithë të cilët në 5 vjetët e fundit kanë jetuar në Prishtinë, me i stimuluar ato nëna dhe me gjetur formë me rritur shumën.

Adelinë Sahiti dha sqarime për këtë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për subvencionimin e nënave lehona, përfituese të skemës sociale (për të porsalindurit e tyre) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Bersant Beka tha se e kanë parë të arsyeshme me i kryer këto zgjedhje brenda këshillave, meqenëse nga viti 2012 nuk janë mbajtur, të formohet komisioni për mbarëvajtjen e këtyre zgjedhjeve, por patëm probleme meqenëse është Rregullorja dhe Udhëzimi administrativ, por kemi propozuar dhe kemi bërë kërkesë si pyetje për Zyrën ligjore dhe besoj se do ta kemi

përgjigjen prej tyre dhe ne po propozojmë me shkuar në bazë të Udhëzimit administrativ meqenëse është i fundit.

Nora Kelmendi tha se Udhëzimi administrativ është në kundërshtim me Rregulloren e vet Komunës, andaj duhen të ndryshohen tri pika në Rregullore: pikat 5, 11, dhe 13, pastaj pas Rregullores me votuarë këtë komisionin.

Bersant Beka pyeti se a jeni të pajtimit se në Rregullore i kemi tri pika për t'i ndryshuar për komision, për mandat dhe kompensim. Te kompensimi, e kemi pak problem punën e kompensimit, sepse në disa Udhëzime administrative nëse kalon shuma prej 100 €, duhet me marrë kod në Ministrin e Financave. Unë kisha propozuar që 50 -75 € me qenë kompensimi.

Gëzim Sveçla pyeti se a mund të jetë 99 €.

Bersant Beka theksoi se me këtë Rregullore shumë mirë po fuqizohen BL-të, të paktën me pasur një ndjenjë, të paktën disa benificione, se vetëm 2 € i kanë mbushje në muaj. Me ndonjë vendim të Kuvendit komunal a mundet me pasur ndonjë gjë?

Valbona Ahmeti - Makolli tha se me Vendim të Kuvendit komunal prej mallrave dhe shërbimeve, vetëm duhet me pasur numrin e saktë, vlerën e saktë me Vendim të Kuvendit komunal.

Bersant Beka tha se e kemi te neni 13, kompensimi i kryetarëve të BL-ve përcaktohet nga Kuvendi komunal me vendim të veçantë, ne i kemi 42 nga 99 € për 12 muaj.

Osman Bllaca dha sqarime se deri në shumën 0-80 € nuk paguajnë taksa as kontribute, nëse kalon mbi 80 € i nënshtrohen taksave dhe kontributeve.

Jeta Rafuna - Hasani tha se pajtohet për mbajtjen e zgjedhjeve për BL. Ashtu si tha edhe drejtori, që nga viti 2012 nuk janë mbajtur zgjedhje, ndërsa sa i përket kompensimit ndoshta është mirë shuma me qenë që mos iu ndalur kontribute, në seancë vendosim.

Leutrim Retkoceri propozoi që në pikën 6 të futet plotësim-ndryshimi i Rregullores dhe të harmonizohet me Udhëzimin administrativ, pastaj të bëhet zgjedhja e komisioneve. Unë mendoj se në situata të tillë është e nevojshme si për kriteret tjera që është vendosur me një udhëzim administrativ të ketë edhe kjo pagese. Sa i përket pagesës mbi 100 €, duhet me hap kod për pagesën e këtyre punëtorëve.

Valbona Ahmeti - Makolli dhe sqarime të nevojshme.

Bersant Beka tha se te pika 12 thotë "Kompensimi i qytetarëve të këshillave lokalë, pika 2 thotë kompensimi për kryetarët e këshillave lokalë bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative.

Gëzim Sveçla pyeti se kush është përfaqësues nga Shoqëria Civile dhe përfaqësuesi i fshatit, vendbanimit ose lagjes, ky është alternativ apo? Këta anëtarët e komisionit a kanë kompensim gjatë kohës sa zgjat ky proces i zgjedhjes së këshillave?

Osman Bllaca dha sqarime për këtë.

Bahri Gashi tha se shuma e kompensimit është shumë e vogël. A kemi mundësi me gjetur një model që me bërë diçka ne në këtë drejtim si asamble? Të gjithë anëtarët e komisionit a janë vullnetarë, apo qenka problem këta me shkua çdo takim, çdo fshat, problem është nëse mbetet në baza vullnetare.

Leutrim Retkoceri tha me bërë ne një propozim, a mundet mu rritur pak mëditja e anëtarëve të komiteteve, në mënyrë që me iu rritur edhe këtyre kryetarëve të fshatrave.

Bersant Beka theksoi se plotësohet pika 12 dhe e kemi më lehtë.

Osman Bllaca dha sqarime.

Gëzim Sveçla pyeti se a ka ndonjë procedurë kohore sa ka me zgjatur kjo zgjedhja.

Nora Kelmendi tha të gjitha janë të parapara në Udhëzim administrativ.

Valbona Ahmeti - Makolli propozoi që derisa të bëhet ndryshimi i Rregullores dhe zgjedhjet, me pasur një pasqyre financiare, drejtori me paraqitur çka po përfshihet në të dhe është e drejtë e kryetarit me i subvencionuar me aprovim të Kuvendit.

Milazim Vitija tha se ka mbi 22 vjet që është kryetar i BL-së në Marec. Është e vërtetë se në kohën sa ka qenë kryetar Ismet Beqiri, janë paguar nga 29 € mëditje çdo kryetar i BL- së që ka mbajtur atë mbledhje, shuma më e mirë për kompensim kishte me qenë 80 € për çdo mbledhje në muaj që merr pjesë, mirëpo shuma prej 50 € mendoj se është shumë pak. Ta kemi parasysh se nuk kanë qenë funksionale, duhet me i funksionalizuar, mirëpo është mirë me gjetur edhe një formë për anëtarët që me i kompensuar.

Valbona Ahmeti - Makolli njoftoi se javën e kaluar është formuar komisioni prej kryetarit për shqyrtimin e Ligjit të Prishtinës, sepse ka mangësi të përgjithshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Shqyrtimi i përgjigjes nga MAPL, lidhur me Vendimin për caktimin e lokacionit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve.

Mimoza Sylejmani tha se zyrtari i Zyrës ligjore, Fatos Dibra, në mbledhjen e Kuvendit e shpjegoi këtë çështje.

Gëzim Sveçla shprehu mendimin se titulli i pikës është shumë i çuditshëm, Asambleja e Komunës me shqyrtimin e përgjigjes nga MAPL. Ne nuk jemi organ me i shqyrtuar dhe nuk jam në dijeni për qëllimet e Qeverisjes aktuale, a po kërkon me u shtyrë me Ministrinë. Mendoj se deri në seancën e radhës ka kohë me ndryshuar, me marrë një lokacion me MAPL-në ku nuk pengon, me votuar lokacionin dhe me fillua me punën.

Luljeta Selimi tha se Udhëzimi administrativ për publikim të akteve thotë se çdo vendim që miratohet në Kuvend komunal, jemi të obliguar me i dërguar në MAPL për konfirmimin e ligjshmërisë, e MAPL brenda 15 ditëve na e kthen përgjigjen cili Vendim i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë dhe cili nuk i nënshtrohet.

Florim Krasniqi dha sqarime lidhur me këtë pikë, ku ceku se është një Rregullore në fuqi, Rregullorja nr. 06/2021, e cila përcakton se cilat akte i nënshtrohen ligjshmërisë, neni 9, pika 2.1 lista është në kuadër të kësaj Rregulloreje, është edhe një listë me vendime se cilat i nënshtrohen ligjshmërisë dhe cilat jo. Mendoj se në këtë rast është bërë një lëshim, nëse i referohemi kësaj rregulloreje që ne nuk kemi pasur nevojë me dërguar Vendimin për caktimin e lokacionit në MAPL dhe lokacioni ku është caktuar është analizuar ajo parcelë në aspektin e planifikimit, në bazë të normave të planifikimit i plotëson të gjitha kriteret.

Po ashtu, ajo tha se e dimë që është Ligji, udhëzimet dhe rregulloret, të cilat shpesh bien në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Gëzim Sveçla pyeti se për cilën rregullore konkretisht e keni fjalën është dhe ekzekutivi i Komunës a i ka biseduar këto gjëra me Zyrën ligjore të MAPL-së.

Florim Krasniqi tha se është fjala për Rregulloren, nr. 06/2021, neni 9, pika 2.1, dhe ne si Planifikim nuk kemi biseduar me MAPL-në.

Nora Kelmendi tha se nuk është rregull me e sjell përgjigjën e Zyrës ligjore me e shqyrtuar ne asamblistët, ekzekutivi i shqyrton këto gjëra, hera e parë është që po na sillet.

Leutrim Retkoceri tha se te kjo përgjigje që e kemi marrë nga MAPL dhe MMPH, te arsyetimi po thotë: paragrafi i parafundit, bazuar në atë çka është cekur më lartë, MMPH kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe kryetari i Komunës, që të ndërmerr vendime konkrete që aktin e Komunës ta formatizoj me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Unë kisha thënë se duhet me ndryshuar titullin e pikës dhe Zyra ligjore me pasur çka nuk është në harmoni me Ligjin dhe ne nuk ishim shkuar me shfuqizim, por me plotësim të Vendimit, dhe ai kishte shkuar prapë në Ministri, në mënyrë që të kryhet puna më shpejt.

Gëzim Sveçla ceku se në arsyetim te paragrafi i fundit, thotë: "Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL -së, për çfarëdo sqarim të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim". Andaj, mendoj se duhet Komuna të bisedojë se ku nuk është në rregull vendimi që e ka marrë asambleja, çka duhet me vepruar dhe neve me na e sjellë atë vendim dhe ne e votojmë.

Leutrim Retkoceri kërkoi që të riformulohet, të ndryshohet titulli i pikës së rendit të ditës, vjen me atë pikë të rendit të ditës jo shfuqizim, por harmonizim i vendimit dhe ta procedojmë, ta zgjidhim këtë çështje.

Milazim Vitija theksoi se nëse bijën fekalet te liqeni i Badovcit nuk do ta votoj. Unë e njoh atë pjesë, dhe është konsultuar me kryetarin, ku ai ka thënë se do të jetë një strehimore me

standarde që i kanë edhe vendet tjera. Tani jam bindur se duhet me votuar këtë, se kjo punë është shumë urgjente.

Nora Kelmendi u interesua për strehimoren e geneve, që është caktuar lokacioni, është fituar tenderi, por çka po ndodh me atë strehimore?!

Mimoza Sylejmani dha sqarime lidhur me këtë çështje.

Bahri Gashi tha për këtë strehimore që na dha informata drejtoresha, është 300m² i nxë vetëm 20 qenë.

Mimoza Sylejmani theksoi se aty vendosen edhe bokset, kjo është vetëm për trajtim, ata nuk rrinë brenda.

Bahri Gash u shpreh se kjo pikë është e ndjeshme, kush e ka përgjegjësinë le të merret pak më intensivisht me këtë punë. Unë më herët e kam kundërshtuar, me u hequr kjo pikë prej rendit të ditës, për të ardhmen me i parë hapat e tyre, thirreni një seancë të jashtëzakonshme për këtë punë e mos e sill në asamble pa asgjë.

Gëzim Sveçla shprehu mendimin se duhet pyetur Ministrinë çka duhet ne me ndryshuar këtu, vjen me ndryshime në Kuvend dhe votojmë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua shqyrtimi i përgjigjes nga MAPL, lidhur me Vendimin për caktimin e lokacionit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA në Prishtinë.

Valbona Ahmeti - Makolli dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim.

Gëzim Sveçla pyeti se a ka qenë edhe në fillim të mandatit i njëjtë problem.

Valbona Ahmeti - Makolli tha se po i njëjtë problem ka qenë edhe herën e kaluar, këtu është një keq menaxhim. Unë kam kërkuar prej aksionarëve raport financier, ku kanë shkuar mjetet, çka mundemi me ndryshuar. Ne këtë e kryejmë, nuk është problem, por është vetëm një zgjidhje mos me na u bllokuar kamionët.

Ne shërbimet që i kemi çdo muaj i kemi të paguara, e kam reportin financier edhe na çka i kemi paguar si shërbim qysh është marrëveshja.

Bahri Gashi pyeti se a nuk mundemi me u nda nga komunat tjera, se sa po paguajmë për komunat tjera.

Valbona Ahmeti - Makolli tha se sipas njoftimeve të nënkyetarit, edhe komunat tjera janë të interesuara me u ndarë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për lënien në diskutim për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01. nr. 35-94056, dt.04.05.2015, të Planit rregullues "Arbëria 3".

Mimoza Sylejmani bëri të ditur se propozimi ka ardhur prej kryetarit, i cili ka pasur takime. Unë nuk kam qenë në asnjë takim as me Ministrinë, as me Ambasadën.

Gëzim Sveçla tha se kur e kemi qitur këtë na thoshit jo nuk bënë kjo.

Mimoza Sylejmani tha unë jam parimore, Ministria çka do që i kthen të jashtëligjshme për mua është rregull, Ministria e Planifikimit. Po kërkoj diskutim me Ministrinë dhe me të gjithë aktorët për t'i sqaruar gjërat e mos me na u kthyer.

Gëzim Sveçla shprehu mendimin se ka mu bërë problem këtu, sepse qytetarët e lagjes "Kalabria" kanë me reaguar.

Bahri Gashi pyeti se a mundemi me shti Kalabrinë paketë. Po e kthejmë pra edhe Kalabrinë pikë të veçantë. Unë po propozoj Kalabrinë me qitë pikë të rendit të ditës, sepse që të dyja me të njëjtin arsyetim kanë shkuan.

Kryesuesi tha se ne tani po e përfundojmë këtë, për Kalabrinë kemi me biseduar ende.

Gëzim Sveçla kerkoi që në seancë me e qitë para rendit të ditës, si propozim, atë që tha Bahriu që paralelisht me këtë vendim për shfuqizim, kemi me shfuqizuar edhe vendimin për Kalabri, që e keni votuar atë ditë, dhe kemi me votuar na edhe për Arbërinë që e ka kérkuar Amerika edhe kemi me votuar për Kalabrinë.

Jeta Rafuna tha se e përkrahim këtë propozimvendim, sa i përket Kalabrisë, kryetari ua ka sqaruar mirë banorëve se në shtator e përfundon Hartën zonale.

Mirsad Vitia tha se drejtori nuk ka thënë ashtu.

Leutrim Retkoceri tha sa i përket propozimit të kësaj pike kamë dy kérkesa: që të analizohet titulli i kësaj pike, të rregullohet dhe materialet e kësaj pike, në bazë të kësaj çka flitet, po procedojmë dhe pastaj të sillen të kompletuara në seancën e radhës që të votohet.

Këtu është bërë një lëshim, i cili nuk është dashtë të ndodhë, mos me ardhur hiq në seancë. Tash nëse vjen unë vetëm një kérkesë e kam, të trajtohet me kujdes, nuk ka krahasime, nuk është njëjtë.

Bahri Gashi tha se jemi kundër, edhe atëherë kemi thënë mos me u shfuqizuar dhe na prapë jemi me u kthye ai vendim.

Gëzim Sveçla tha se prej kur është votuar për shfuqizim e deri më tanë nuk ka asnjë ndryshim, të paktën s'kemi pa asnjë kérkesë zyrtare që ka ardhur nga Ambasada amerikane.

Mimoza Sylejmani bëri të ditur se kanë pasur takim me kryetarin, por se a ka ardhur ndonjë kérkesë nuk është dijeni.

Leutrim Retkoceri tha për këtë pikë që po kérkojmë ne materiale, jam i bindur që nëse ka dokumente të cilat i kérkojmë, në bazë të atyre dokumenteve na edhe do të votojmë.

Bahri Gashi tha se kjo ka me u kryer, por paralel asgjë nuk është, me shikuar edhe interesin e qytetarëve nuk qëndrojnë njëjtë.

Milazim Vitija tha se shumë mirë kryetari e shpjegoi për Planin që kemi me dërguar dhe kemi me shqyrtua atë Plan urbanistik të Kalabrisë, sepse na e ka kthyer Ministria. Po të mos e kishim kthyer ne atë vendim, atëherë Ministria e kish dërguar në gjykatë, e qytetarëve të Kalabrisë iu kishin shkuan 4 -5 vjet, kryetari po donë me ju bërë zgjidhje afatgjate, qëllimi është shumë i mirë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për lënien në diskutim për plotësim ndryshimin e Vendimit, 01. nr. 35- 94056, dt. 04.05.2015, të Planit rregullues "Arbëria 3" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Të ndryshme

Milazim Vitija iu drejtua drejtoreshës së Financave, duke e pyetur se a do ta zgjedh komisionin për heqjen e taksën, që të mos e diskutojmë çdo seancë këtë çështje se është kërkesë e qytetarëve, se ata i kanë tokat e papërkthyera dhe nuk mund të marrin subvencione as kredi, me iu cenuar të drejtën, kështu që formojmë komisionin dhe e heqim këtë taksë, në mënyrë që të lironen qytetarët nga kjo barrë. Këtë taksë e ka vetëm Komuna e Prishtinës.

Valbona Ahmeti - Makolli dha sqarime.

Kryesuesi pyeti se a kemi të drejt ne si asamblistë me iniciuar këtë dhe me futur në rendin e ditës. Nëse kemi të drejt, atëherë nuk kemi çka me biseduar, e propozojmë në Kuvend dhe futet.

Gëzim Sveçla tha se në seancën e radhës ka me qenë propozimi i grupit tonë me u futur në rend dite çështja e taksës së transaksionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami

